

UDHËZIM

Nr.14, datë 21.4.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.8, DATË 26.1.2009 "PËR PËRCAKTIMIN E SKEMËS SË DUHUR PËR SHTYPJEN E BILETAVE, SHPËRNDARJEN DHE KONTROLLIN E HEDHJES SË TYRE NË PËRDORIM"

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 13 pika 2 të ligjit nr.10 033, datë 11.12.2008 "Për lojërat e fatit", Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.8, datë 26.1.2009 "Për përcaktimin e skemës së duhur për shtypjen e biletave, shpërndarjen dhe kontrollin e hedhjes së tyre në përdorim", bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 riformulohet si më poshtë:

"1. Shtypja e biletave të lojërave të fatit kryhet në përputhje me ligjin nr.10 033, datë 1.12.2008 "Për lojërat e fatit", të ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij".

2. Pika 4 riformulohet si më poshtë:

"4. Biletat e lojërave të fatit shtypen në shtypshkronjën e letrave me vlerë".

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE

Ridvan Bode